



Pranim / Dorezuar Primesha / Prodado Received / Delivered	10.02.2023	3	Viti God Year
Organ / Njësia Organ / Jedinstvo Org. / Unit	Nr. Prot. Pr. / Prot. No.	Shënjë Printog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKINSHQIL	1677/2023		1/6



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1230/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti - kryetar, Malsore Gashi – Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi -anëtarë, me Rushit Kajtazi–Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1230/2022 të datës 20.12.2022,të parashtruar nga kundër organit të punësimit Komisioni i Pavarur për Media, në çështjen juridike “Kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me Nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, Nenin 16 paragrafi 3 dhe Nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 03.02.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet** si e bazuar ankesa me numër A.nr.1230/2022 e datës 20.12.2022 të parashtruar nga
- II. **Shfuqizohet** Vendimi Nr.Ref:2212/1016/DL/hzg i datës 02.12.2022 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komisionit të Pavarur të Mediave, ndërsa **Anulohet** procedura e rekrutimit për pozitën e punës “Zyrtar i Lartë për Monitorim Regjional”, e shpallur me datë 20.09.2022 nga Komisioni i Pavarur i Mediave si dhe çdo veprim që rrjedhë nga kjo procedurë pranimit.
- III. **Obligohet** Kryeshefi Ekzekutiv i Komisionit të Pavarur të Mediave që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e tij.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## A r s y e t i m

Ankuesi me datë 20.12.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 8234/2022 të regjistruar nën shenjen A.nr.1230/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.2212/1016/DL/hzg të Komisionit për Zgjidhjen e Ankesave në Komisionin e Pavarur për Media, për shkak të shkeljeve procedurale gjatë rekrutimit dhe vlerësimit jo të drejtë të rezultateve lidhur me pozitën e punës *Zyrtar i Lartë për Monitorim Regjional*, tre (3) vende pune.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill, pretendon se procedura e rekrutimit është përcjellë më shkelje procedurale dhe materiale të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me kërkesën që të vërtetohen këto shkelje dhe të detyrohet Komisioni i Pavarur i Mediave që të bëhet rivlerësimi i ankuesit në procedurën e rekrutimit si dhe të bëhet publikimi i plotë i rezultateve përfundimtare.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 23.12.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komisioni i Pavarur për Media, ndërsa me datë 10.01.2023, ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:** Ankesën me numër të protokollit 4664/2022 të datës 11.08.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin Nr.02/Zyrtarisht të datës 14.07.2022 të Njësisë se Burimeve Njerëzore; Njoftimin e datës 06.07.2022 për përfshirjen në listën e ngushtë; Konkursin me numër reference RN00009152 të datës 03.06.2022; Konkursin me numër reference RN00008512 të datës 28.02.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 4745/2022 të datës 15.08.2022; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 4919/2022 të datës 23.08.2022; Zarin e datës 16.08.2022; Shkresën lidhur sistemin informative për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore lidhur me konkursin e datës 18.03.2022; Njoftimin me Nr.02/ Zyrtarisht të datës 06.04.2022; Vlerësimi i aplikanteve në sistemin informativ me numër reference RN00009152; Emalin e datës 21.07.2022; Vendimin me Nr.02/zyrtarisht të datës 14.07.2022 të Kryetarit të Komunës së Deçanit; Renditjen përfundimtare të kandidateve të datës 12.08.2022; Njoftimin e datës 12.08.2022 për përfundimin e procesit të vlerësimit, për ngritje / Avancim në detyrë në pozitën e punës "*Udhëheqës i Sektorit për Buxhet dhe Financa*"; Njoftimin me e datës 06.07.2022 për përfshirjen në listën e ngushtë; Konkursin me numër reference RN00009152 e datës 03.06.2022 të shpallur në Sistemin Informativ të Burimeve Njerëzore; Konkursin me numër RN.00008512 të datës 28.02.2022; Akt emërimit me numër 02/20305 të datës 02.09.2015; Diplomën universitare me Nr.4249 të datës 15.04.2014 të ankuesit; Akt Emërimit me numër 12928 të datës 02.06.2018; Diplomën universitare me Nr.788 të datës 03.11.2020; Diplomën universitare me Nr.38/18 të datës 04.11.2019; Emalin e datës 12.09.2022 të drejtuar Këshillit të Pavarur; Emalin e datës 12.09.2022 të Këshillit të avancuar drejtuar Emalin e datës 09.09.2022 të Këshillit të Pavarur drejtuar Aktin përcjellës me Nr.02/zyrtarisht të datës 12.09.2022; Listën e aplikantëve të aprovuar dhe të refuzuar nga Sistemi i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore; Dosjen e

kandidates së përzgjedhur; Aplikacionin e datës 27.06.2022 Dokumentin e identifikimit; Certifikatën me Nr.09/2022 të datës 11.02.2022 lidhur me përfundimin e trajnimit Moduli i Shpenzimeve; Formularin e vlerësimit në punë të datës 27.01.2022 të nëpunësve dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtuese i mesëm i ulët dhe profesional;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të provave materiale të parashtruara nga palët në procedurë konstatoi së ankesa e ankuesit është e bazuar, sepse:

Nga administrimi i provave materiale rezulton se Komisioni i Pavarur për Media, më datë 20.09.2022 ka shpallur Konkursin me numër reference 2209/803/ADM/na për pozitën e punës *Zyrtar i Lartë për Monitorim Regjional, tre (3) vende pune*, ku si kritere formale për pjesëmarrje në rekrutim kanë qenë të përcaktuara:

1. *Diplomë universitare në fushën e Gazetarisë, Komunikimit Masivë; Filologjisë; Filozofisë; Marrëdhënie Ndërkombëtare; Drejtësisë dhe Ekonomik.*
2. *Tre (3) vite përvojë pune profesionale të përafërta me natyrën e punës së KPM-së, përvojë pune në institucionet publike apo private, ose në ndonjë organizatë ndërkombëtare, me theks në fushën e gazetarisë, komunikimit masivë dhe të kulturës.*

Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi dhe si rrjedhojë i njëjti ka hy në listën e ngushtë, i është nënshtruar fazës së testimit me shkrim dhe intervistës me gojë, mirëpo nuk ka rezultuar të jetë kandidatë i suksesshëm për pozitën përkatëse të punës.

Sipas Raportit me shkrim të datës 14.10.2022 lidhur me listën e ngushtë të kandidatëve, rrjedh se për pozitën e punës *Zyrtar i Lartë për Monitorim Regjional*, në listën e ngushtë janë përfshi:

ndërsa nuk kishin arritur të hynin në listë të ngushtë kandidatet: \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_  
Rrjedhimisht, sipas Listës me shkrim lidhur me renditjen përfundimtare të kandidatëve (*pa datë, vetëm me nënshkrime*), në testin me shkrim dhe intervistën me gojë, kandidatet janë renditur si në vijim: \_\_\_\_\_ pikë, \_\_\_\_\_ pikë dhe \_\_\_\_\_ pikë, gjegjësisht të njëjtat sipas njoftimeve të datës 01.11.2022 janë shpallur kandidatë të suksesshëm.

Ankuesi i pakënaqur me njoftimin për kandidatët e suksesshëm, me datë 18.11.2022 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhen e Kontesteve dhe Ankesave të Komisionit të Pavarur të Mediave, ndërsa me datë datës 02.12.2022 Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me Vendimin Nr.Ref:2212/1016/DL/hzg ka refuzuar ankesën e ankuesit dhe ka lënë në fuqi vlerësimin përfundimtar të kandidatëve të suksesshëm.

Kolegji i Këshillit me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit lidhur me ligjshmërinë e zhvillimit të procedurës së rekrutimit, ka analizuar dosjet e administruara të kandidatëve të përzgjedhur sikurse edhe të ankuesit, ka gjetur sikurse në *vijim*: kandidatja e përzgjedhur \_\_\_\_\_ posedon Diplomën me numër:127/0412 të datës 19.04.2012 përmes të cilës dëshmohet se e njëjta me datë 03.02.2007 ka mbaruar studimet themelore universitare në Fakultetin Ekonomik-Dega Menaxhment dhe Informatikë në Kolegjin Universitar-FAMA, po ashtu posedon vërtetimin e lëshuar nga Indeksonline (*nuk është e evidentuar data apo shifra e protokollit*) në të cilin specifikohet se e njëjta ka kryer punën

praktike për periudhën kohore janar-korrik 2012, si dhe letër referencën e lëshuar nga personi fizik (e cila shiksesë nuk përmban as vulë dhe as datë) mbi bazën e të cilës pretendon se e njëjta ka punuar në Aztech, pa specifikuar periudhën kohore, ndërsa kandidatja tjetër e përzgjedhur posedon Diplomën me numër:642 të datës 22.01.2010 përmes të cilës dëshmohet se e njëjta me datë 28.10.2009 ka mbaruar studimet themelore universitare në Fakultetin e Filologjisë-Drejtimi i Letërsisë Shqipe në Universitetin e Prishtinës, sikurse posedon vërtetimin e datës 26.09.2022 lëshuar nga AVAV Group Sh.P.K përmes të cilës paraqitet përvojë e punës në cilësi të menaxheres së marketingut nga data 01.03.2020 deri në datën e lëshimit, po ashtu posedon Letër referencën e datës 31.03.2017 përmes të cilës paraqitet përvojë e punës në cilësi të Zyrtares së marketingut nga data 05.01.2014 deri me datë 31.06.2016 si dhe ka ofruar Letër referencën e datës 22.04.2022 përmes të cilës paraqitet përvojë e punës së ankueses në IT Vision ndërmjet periudhës kohore nga data 01.02.2011 deri me datë 30.11.2013, ndërsa ankuesi posedon Diplomën me numër:2394 të datës 16.01.2013 përmes të cilës dëshmohet se i njëjti me datë 24.12.2008 ka mbaruar studimet themelore universitare në Fakultetin Filozofik-Departamenti i Shkencave Politike në Universitetin e Prishtinës, po ashtu posedon Diplomën me numër:242 të datës 03.07.2013 përmes të cilës dëshmohet se i njëjti me datë 14.06.2013 ka mbaruar studimet Master në Fakultetin Filozofik-Departamenti i Shkencave Politike në Universitetin e Prishtinës, si dhe posedon letër referencën e datës 15.07.2015 lëshuar nga prej USAID Kosovo Effective Rule of Law Program përmes të cilës paraqitet përvojë e punës së ankuesit nga data 09.08.2013 deri me datë 08.11.2013, si dhe posedon letër referencën e datës 24.10.2016 lëshuar nga prej UNDP përmes të cilës paraqitet përvojë e punës së ankuesit nga data 01.09.2015 deri me datë 31.03.2016, si dhe posedon letër referencën e datës 15.06.2020 lëshuar nga IKS-Kosovar Stability Initiative-IKS përmes të cilës paraqitet përvojë e punës së ankuesit nga data 01.10.2016 deri me datë 31.12.2018.

Nga se u tha më lartë, Kolegji i Këshillit nga analizimi i dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve të përfshirë në listën e ngushtë, ka gjetur se njësia përgjegjëse nuk ka vërtetuar drejt gjendjen faktike sepse bazuar në shkresat e lëndës gjegjësisht sipas dëshmive të dorëzuara nga kandidatët me rastin e aplikimit, është konstatuar se dy (2) prej kandidatëve të përzgjedhura si dhe ankuesi, lidhur me përvojën e punës kanë prezantuar vërtetime dhe letër referenca, rrjedhimisht në vlerësimin e Kolegjit si dhe duke u bazuar edhe në konstatimin e Gjykatës së Apelit sipas Aktvendimit me numër AA.nr.614/2022 të datës 27.09.2022, referenca lidhur me përvojën e punës në sektorin privat nuk janë dëshmi të mjaftueshme dhe të vlefshme për të provuar faktin e përvojës së punës, nëse të njëjtat nuk janë të shoqëruara me vërtetim apo kontratën e punës nga organi punëdhënës dhe vërtetimin nga organet përgjegjëse gjegjësisht Administrata Tatimore dhe Fondi i Kursimeve Pensioneve, nga rrjedh se Komisioni Përzgjedhës me rastin e përfshirjes sikurse të ankuesit dhe dy (2) prej kandidatëve të përzgjedhura në listën e ngushtë kanë vepruar në kundërshtim me nenin 16 paragrafin 1 dhe nenin 20 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Rregullores Nr.02-2021/EXD për Procedurën e Rekrutimit dhe Emërimit në Zyrën Ekzekutive të Komisionit të Pavarur të Mediave që ka përcaktuar se: "16.1 Përzgjedhja e kandidatëve bëhet përmes shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikacioneve të dorëzuara nga kandidatët e interesuar për pjesëmarrje në procesin e rekrutimit; 20.1 Anëtarët e Komisionit Përzgjedhës vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve në vijim: 1.2 Përvoja e punës që konsiston në eksperiencën përkatëse profesionale dhe menaxheriale varësisht nga pozita e klasifikuar e punës" si

K  
M  
E  
K  
A  
D  
S  
J  
B  
3  
A  
A

dhe në kundërshtim edhe me nenin 11 paragrafi 1 të Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës i cili përcakton që: *“Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve”* pasi që tre (3) kandidatë në procedurë e të cilët janë përfshirë në listën e ngushtë, prej të cilëve dy (2) janë përzgjedhur, nuk i kanë plotësuar kriteret e konkursit apo nuk kanë arritur ta dëshmojnë me prova se i plotësojnë kriteret e konkursit sa i përket përvojës së punës, nga rrjedh se pretendim ankimor i ankuesit lidhur shkeljet procedurale dhe materiale të legjislacionit material për shërbimin civil është i bazuar. Tutje, Kolegji me rastin e shqyrtimit të dosjes së të lartpërmendurave ka pasur parasysh pasqyrën e gjendjes së llogarisë në trust për kandidaten mirëpo e njëjta shkresë nuk ka të evidentuara pasqyrimin e pagesave të kontributeve që ndërlidhen me prezantimin e përvojës së punës.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit sjell në vëmendje se sipas neni 17 paragrafi 1 të Rregullores Nr.02-2021/EXD për Procedurën e Rekrutimit dhe Emërimit në Zyrën Ekzekutive të Komisionit të Pavarur të Mediave që përcakton se: *“Gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikacioneve, Komisioni Përzgjedhës mund të verifikojë me institucionet përkatëse vërtetësinë e të dhënave të siguruar nga kandidatët”*, Komisioni Përzgjedhës ka mundur në çdo rast të verifikojë vërtetësinë e dhënave të paraqitura të përvojës së punës nga kandidatët në procedurë duke kërkuara sqarime apo dokumentacione shtesë, megjithatë nga shkresat e administruara të lëndës Kolegji i Këshillit nuk gjetur asnjë veprim të tillë procedural që është ndërmarrë nga të njëjtit, madje një çështje e tillë nuk është specifikuar apo dëshmuar as në korrespondencën zyrtare, gjegjësisht në përgjigjen në kërkesë të datës 20.01.2023 së bashku me shkresat e lëndës e cila në Këshill është pranuar dhe regjistruar me numër protokolli:593/2023.

Kolegji i Këshillit meqenëse ka konstatuar se lidhur me procedurën e zhvilluar të rekrutimit të zhvilluar nga Komisioni i Pavarur për Media, për pozitën e punës *Zyrtar i Lartë për Monitorim Regjional, tre (3) vende pune*, ka shkelje thelbësore të dispozitave të ligjit material, nuk është lëshuar në shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit lidhur me shkelje eventuale procedurale, ngase shkeljet e tilla nuk mund të përligjen dhe të njëjtat përbëjnë bazë të mjaftueshme për anulimin e procedurës së rekrutimit në fjalë.

Andaj, nisur nga të gjeturat dhe konstatimet si me lartë, Kolegji i Këshillit vlerëson së procedura e rekrutimit të shpallur sipas konkursit të datës 20.09.2022 për pozitën e punës *Zyrtar i Lartë për Monitorim Regjional, tre (3) vende pune*, nga Komisioni i Pavarur për Media, është i përfshirë me shkelje të dispozitave të Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, kështu që në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dh 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative një procedurë pranimi e përfshirë më shkelje të dispozitave procedurale dhe materiale konsiderohet procedurë e paligjshme, andaj me qëllim të vendosjes së ligjshmërisë Kolegji i Këshillit në mbështetje të Nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi në dispozitiv të këtij vendimi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**

Lënda: A.nr.1230/2022, datë 03/02/2023

**Rushit Kajtazi**

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Arben MEHMETI**

Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit
- Kryeshefit Ekzekutiv të Komisionit të Pavarur të Mediave;
- Udhëheqësit të Personelit në Komisionin e Pavarur të Mediave, dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.